

# **STATUSI DHE AKT**

## **THEMELIMI**

**I**

## **SHOQERISE**

*“Classic Rentals Al”*

*Administratori*

*Kleand Bendaj*

*Date 28.03.2024*

Tiranë me 28.03.2024

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI**

I

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA**

**“ Classic Rentals Al ”**

**KREU I**

**HYRJE**

**Neni 1**

Shoqeria me përgjegjësi të kufizuara “ **Classic Rentals Al** ” sh.p.k është themeluar nga ortaku:

- Kleand Bendaj ,shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me ID personal J20820073B.
- Irkenc Hyka ,shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me ID personal J21007055I.
- Erjon Lleshi ,shtetas Shqiptar, lindur në Valbona dhe banues në TIRANË, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me ID personal I40606071C.

Themeluesi, i cili është madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin “ Për Tregtaret dhe shoqëritë tregtare” hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**KREU II**

**PERKUFIZIME**

**Neni 2**

Emertimi i shoqërise

Emertimi i shoqërisë është “ **Classic Rentals Al** ”

### **Neni 3**

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjisacionit në fuqi të Republikës së Shoqërisë, vecanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statute. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qëndrën Kombetare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurencës" të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 4**

#### **Forma**

Shoqëria "**Classic Rentals Al**" sh.p.k është "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara"

#### **Neni 5**

#### **Selia**

1. Tirane, njësia bashkiake nr 1, rruga "Gjon Krisili", ndertesa nr 21.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapi filial të tjera brënda territorit të Republikës së Shqipërisë në varësi të selisë qëndrore që ndodhet në rrëthin e Tiranës.
3. Vend I mbajtjes së asamblesë së përgjithshme është selia e shoqërisë. Nëse bihet dakort me unanimitet, mbledhja e asamblesë mund të kryhet në një vënd tjeter.

#### **Neni 6**

#### **Objekti i Veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Tregti të automjetesh, dhenie me qera automjetesh.

#### **Neni 7**

#### **Vula e shoqërisë**

1. Shoqëria ka vulën e saj, në brëndësi të së cilës shkruhet I plotë emërtimi dhe forma e saj juridike.
2. Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Kohezgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jëtë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

## **Neni 9**

### **Veprimet e lejuara të shoqërisë**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë asambleja e Përgjithshme me shumicen e ortakeve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit.

## **Neni 10**

### **Marredhenia e punës**

1. Shoqëria për të kryer veprimtarinë e saj sipas objektit të këtij statute do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marredheniet e punës.
2. Kontratat e punës do të lidhen konform ligjit "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" dhe dispozitave të tjera ligjore që rregullojnë marredheniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

## **KREU III**

### **PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË**

## **Neni 11**

### **Ndalimi, konflikti I interest dhe personat e lidhur**

1. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyje në marredhenie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interest të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej te gjithë ortakeve ose të gjithë ortakëve të tjere.
2. Cdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qëndrën Kombëtarë të Regjistrimit.
3. Miratimi I parashikuar jepet, gjithashtu, për cdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me palë të treatë, e cila ka marredhenie personale apo

- financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërime, apo me palë të tjera, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipër janë të lidhur që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundershtim me interest e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interest e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërinë:
- a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motra e bashkëshortit/bashkëshortes;
  - b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c) personat e lidhur me personelin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit ose të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose I birësuari, I afërmimi I shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërinë.
- Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorume.
  - Cdo veprim që kërkon miratim, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interest të personave të përfshirë.
  - Për efekt të këtij statute, me persona të autorizuara për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërise, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likuiduesin e shoqërisë.

### **Neni 12 Parimi I Besnikërisë**

- 1.Gjat ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marre parasysh interest e shoqërisë dhe të ortakëve të tjërë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjose nga ky satut, në rrethana të tjera, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

### **Neni 13**

#### **Ndalimi I Konkurencës**

1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqerinë tregtare mund mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqeri të tjera, që ushtrojnë veprimitari në të njëtin sektorë ekonomik me shoqerinë e pare..
2. Ndalimi I përmëndur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizuar nëpërmjet një autorizimi të posacem, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
3. Ndalimi I përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetur në fuqi edhe pas humbjes së cilësisë apo statutit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurencës, shoqeria mund:
  - a) ta përsashtoje atë nga shoqeria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerje të veprimitarisë konkuruese;
  - c) të ngrejë paq i për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqeria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të trëtë.
  - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brënda tre viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmëndur zbatohen, gjithashu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqeritë tregtare".

#### **Kreu IV**

##### **Neni 14**

##### **KAPITALI THEMELTAR – PJESMARRJA**

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 150.000 Leke (njeqind mijë leke) e cila perfaqeson 3 (tre) kuota, ku njeri ortak zoteron 33.34 % te kapitalit, 1(një)kuote me vlere nominale 50.000 Leke (pesëdhjetë mijë) dhe ortaku tjeter zoteron 33.33% me vlere nominale 50.000 Leke (pesëdhjetë mijë), dhe tjetri ortak zoteron 33.33% me vlere nominale 50.000 Leke (pesëdhjetë mijë).

2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zgjedhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zgjedhimi i kapitalit i prekë të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zgjedhohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

## Neni 15

### Kontributet

Kapitali i shoqërisë do të jetë 150.000 (njeqind mijë), i cili zotërohet nga tre ortakët e shoqërisë:

- **Kleand Bendaj** zotëron 1 Kuotë ose 33.34 % te aksioneve me vlerë nominale 50.000 Leke (Pesedhjete mijë).
- **Irkenc Hyka** zotëron 1 Kuotë ose 33.33 % te aksioneve me vlerë nominale 50.000 Leke (Pesedhjete mijë).
- **Erjon Lleshi** zotëron 1 Kuotë ose 33.33 % te aksioneve me vlerë nominale 50.000 Leke (Pesedhjete mijë).

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

## Neni 16

### Kalimi i kuotave të kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashëgimtari paraardhësi ose pasardhësi, bëken ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund tu kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendimë të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje tu behet ortakeve të tjera të shoqërisë. Kur ortakët që gjëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rrëth cmimit të kuotave të ortakut që kërkon ti kaloj ato, mund ti drejtohet gjykatës që

- të caktoj një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave te të tretët duhet te lajmërohet në një afat sa më të shpejtë, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk I jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rën dakort që kuotat e tij mund ti kalojnë të tretëve.
4. Kalimi I kuotave do të bëhet me kontratë.
  5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

#### Neni 17

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

#### KREU V

#### ORGANET E SHOQËRISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

#### Neni 18

##### Asambleja e Përgjithshme

1. Cdo ortakë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër I zgjedhur prej tij, me kusht që këta të janë autorizuari me prokurë ( përjashtohet përfaqësimi I një ortaku nga një ortak tjetër apo administrator I shoqërisë).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese në të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël të autorizuari, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët , të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votive në Asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund ti drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e cështjeve të posacme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe cështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortake kane të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe të caktojnë cështjen e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë ose nëpërmjet pastës elektonike.

6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditëse t'u dergohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose cështja e kërkuar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që ka bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e përgjithshme merr vendime për cështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
  - a) Përcaktimi I politikave tregtare të shoqerisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
  - c) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës).
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës);
  - h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) Cështje të tjëra të parashikuara nga ligji;
10. Të gjitha vendimet të marra nga Asambleja e Përgjithshme rregjistrohen ne një regjistër të vendimeve, të dhëna të cilat nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.
11. Duhen rrugjistuar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - a) Miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të Raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendime për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë automatikisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme për cështje të tillë si emërimi ose shkarkimi I administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar

dhe likujduesve, miratimi I raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi I pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marre vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave dhe vendimet merren me më shumë se gjysma e votive të ortakëve pjesëmarrës.

15. Asambleja e përgjithshme vndos me shumicë të kualifikuar për cështje të tillë si ndryshimet e statutit, zmadhimi dhe zgjelimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi I saj, shndërrimi I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjeter që parashikohet në ligj. Marrja e vendimevetë vlefshme bëhet vetëm me vendim asambleje ku 100% e ortakeve Jane dakort me vendimet, nese njeri nuk eshte dakort ai vendim duhet te rishikohet.
16. Në se asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në këtë pikë, të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 19

##### **Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator të cilët janë persona fizikë të zgjedhur Brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati I emetimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi competent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi I administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qëndrën kombëtare të Rëgjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

#### Neni 20

##### **Kompetencat e administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarosë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për

- shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencen r shoqërisë;
  - f) Krijojnë rregjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit ;
  - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përsaparashikon ky statut ose ligji.
  3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumice të zakoshme.

### **Neni 21 Emërimi i Parë I Administratorëve**

- Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare emërohet z. Kleand Bendaj, Kleand Bendaj ,shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, I identifikuar me ID personal J20820073B.

- ### **Neni 22 Ekspertë Kontabël të autorizuar**
1. Në rast nevoje si dhe kur kërkonshme nga ligji, kontrolli financier dhe aprovimi I llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabël I autorixuar, I emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
  2. Shkarkimi I ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emerimi I tij, në rast se vërtetohen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

### **KREU VI**

### **VOTA**

### **Neni 23**

### **E drejta e votës**

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Cdo ortak votat që ka mund ti japi vetëm në uniformitet.

### **Neni 24**

### **E drejta për të kaluar rezolutë**

Asambleja e përgjithshme munt të miratojë resolutë pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratoket një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishme të gjithë ortakët personalisht dh eta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

### **KREU VII MARRËDHËNIET FINANCIARE**

#### **Neni 25 Viti Financiar**

Cdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

#### **Neni 26 Bilanci Vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet financiare dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël I autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme.
2. Miratimi I dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brënda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha që përdoret në miratimin e dokumentave është gjuha shqipe.

#### **Neni 27**

#### **Dividentët**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentëve mbi fitimin në raport me kuatat që gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi I vitit financiar të cilit I janë zbritur shumat e lena mënjanë për fondin reserve të domosdoshëm (5% e fitimit të cdo viti, deri sa ky fond të arrijëvlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër I janë zbritur ose I janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 28**

#### **Marredhenia me bankat dhe institucionet financiare**

Shoqëria ka të drejtë të hap llogari likuisuese pranë një ose më shumë bankave ose institucioneve financiare dhe të kryejë veprime likujduese pranë bankave. Në këto banka ose institucione financiare si nënshkrim I parë do të depozitohet ai I administratorit të shoqërisë, I cili duhet të nënshkruaj për të gjitha veprimet

financiare në emër e për llogati të shoqërisë. Ai mund të autorizojë edhe persona të tjerë brënda shoqërisë.

### Neni 29

#### Marrëdhënia me organet tatimore.

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron më 31 dhjetor të cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e të ardhurave, dhe ti dorzoj pranë organizat përkatës të tatimeve.

### KREU VIII NDRYSHIMI I STATUTIT TË SHOQËRISË

#### Neni 30

#### Prishja e shoqërisë

1. Shoqëria prishet me perfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëvë falimenton, bëhet I paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kan mbetur si dhe me trashëgimtarin e radhës së parë të ortakut të vdekur.

#### Neni 31

#### Likujdimi

1. Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likujdus, I cili I paraqet asaj raportin e likujdimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likujdimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullueshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimit.
3. Pas pagimit të kreditorve dhe shlyerjes së kuotave tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbeturë ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

#### Neni 32

### Shndërrimi I shoqërisë

Shndërrimi I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

### KREU IX DISPOZITA TË TJERA

Neni 33

#### Mosmarrveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistences së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit midis ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, do t'li paraqiten për zgjidhje gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 34

Për cështjet që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky Statut nënshkruhet nga themeluesi.

#### THEMELUESIT E SHOQËRISE

Kleand Bendaj

*Kleand Bendaj*

Irkenc Hyka

*Irkenc Hyka*

Erjon Lleshi

*ERJON LLESHI*

#### ADMINISTRATORI

Kleand Bendaj

*Kleand Bendaj*